



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

GJEOLOGJI-MINIERA

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

I-IV-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	GJEOLGJI-MINIERA			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	I-IV-23
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Gjeologji-Miniera”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher në fushën e Gjeologjisë e të Minierave dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi, brigade ose njësie të ngjashme të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin profesional “Gjeologji-Miniera”, niveli IV (KSHK), referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të drejtimit “Gjeologji-Miniera”, të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK; - janë në kushte shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Gjeologji-Miniera”, niveli i IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin Certifikatën Profesionale të Nivelit dhe Supplementin përkatës të saj të teknikut/Menaxherit të mesëm në këtë fushë profesionale, të njohura në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në drejtimin gjeologji-miniera. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e gjeologji-minierave në profesionet: Teknik miniere, Teknik gjeolog, Teknik markshajder (gjeomatik), Teknik shpimi etj. Po ashtu, në varësi të profilit gjeologji-miniera të përfutur në nivelin e III-të, ai mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e gjeologji-minierave, në sektorët e prodhimit e të mirëmbajtjes, në linjat e prodhimit të inerteve në minierat sipërfaqësore, nëntokësore etj.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare</p>			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	I-IV-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Gjeologji-Miniera” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të përforcojë njohuritë profesionale të fituar në Nivelin III, si dhe do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikimi dhe organizimi i punës.

- Të shpjegojë strukturën organizative të ndërmarrjeve në fushën e gjeologji minierave;
- Të shpjegojë llojet e proceseve të punës në miniera dhe grafikun e daljes së punëtorëve;
- Të shpjegojë grafikun e punimeve dhe rëndësinë e zbatimit të tij;
- Të shpjegojë elementet e një urdhri pune dhe mënyrën e zërthimit të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me sektorë ose specialistë të tjerë;
- Të përshkruajë llojet e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë llojet e materialeve dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën dhe rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë mënyrat e organizimit të vendit të punës dhe rëndësinë e organizimit në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e ndarjes së detyrave në ekip;
- Të përshkruajë mënyrat e sigurimit të bazës materiale, mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e sigurimit të burimeve të nevojshme (ujë, energji elektrike etj.);
- Të shpjegojë rëndësinë e sistemimit të vendit të punës;
- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit të pastrimit të vendit të punës, mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të përshkruajë llojet e raporteve dhe mënyrat e hartimit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e evidencave dhe mënyra e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë forma dhe kriteret e vlerësimit të performancës së punonjësve;
- Të përshkruajë legjislacionin në fuqi dhe llojet e masave disiplinore për fushën përkatëse.

Punime në kërkim-zbulim në nëntokë dhe sipërfaqe

- Të shpjegojë llojet e punimeve të kërkim-zbulimit;

- Të përshkruajë metodikat e përdoruar në matjet gjeologo markshajderik(gjeomatik);
- Të përshkruajë llojet e dokumentacionit teknik gjeologo markshajderik (gjeomatik) në sektorin përkatës;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me shërbimin gjeologo markshajderik (gjeomatik) të minierës për proceset e punës në kërkim-zbulimit;
- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e realizimit të punimeve të kërkim-zbulimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e udhëzimit të vartësve për zbatimin e urdhrin të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të punës së kryer;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndjekjes së grafikut të miratuar të realizimit të punimeve të kërkim zbulimit.

Procesi i ajrimit në minierat nëntokësore

- Të listojë elementet përbërës të atmosferës së minierës;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të zbatimit të urdhrin të punës për ajrimin;
- Të listojë pajisjet e ajrimit, funksionet dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të pajisjeve të ajrimit;
- Të shpjegojë skemën e ajrimit;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të punimeve të ajrimit dhe të punimeve të rrugëdaljeve të dyta;
- Të shpjegojë metodat e matjes së përbërësve/elementëve të ajrimit dhe mjetet përkatëse;
- Të listojë normat e lejuara të nivelit të gazeve dhe elementëve të tjerë të ajrimit dhe rëndësinë e respektimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të instruktimit të punonjësve për ajrimin;
- Të listojë llojet e avarive të ajrimit;
- Të shpjegojë masat dhe procedurat që ndiqen në raste emergjence;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e informimit të personave përgjegjës.
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me përgjegjës të ajrimit për kontrollin e skemës së ajrimit për sektorin e tij.

Punimet e hapjes dhe përgatitjes në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të zbatimit të urdhrin të punës për punimet e hapjes dhe përgatitjes;
- Të përshkruajë pasaportat teknike të hapjes dhe përgatitjes, si dhe rëndësinë e zbatimit korrekt të tyre;
- Të përshkruajë mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës për punimet e hapjes dhe përgatitjes, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të listojë llojet e gabimeve të mundshme dhe masat parandaluese dhe korrigjuese të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e leximit dhe interpretimit të projektit të hapjes dhe përgatitjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me shërbimin gjeologo-markshajderik (gjeomatik) për

punimet e hapjes dhe përgatitjes;

- Të listojë llojet e fronteve të punës në hapje dhe përgatitje dhe mënyrat e kontrollit të tyre;

Punimet e shfrytëzimit në nëntokë dhe sipërfaqe

- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrit të punës gjatë punimeve të shfrytëzimit;
- Të listojë pasaportat teknike të shfrytëzimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit korrekt të pasaportave teknike të shfrytëzimit;
- Të listojë llojet e punimeve të shfrytëzimit;
- Të përshkruajë mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës për punime shfrytëzimi, si dhe funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të listojë llojet e avarive në procesin e shfrytëzimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e parandalimit të avarive në procesin e shfrytëzimit;
- Të shpjegojë elementët e sistemit të informimit dhe rëndësinë e tij;
- Të listojë llojet e sistemeve të shfrytëzimit;
- Të listojë llojet e fronteve të shfrytëzimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mënyrave të kontrollit të fronteve të shfrytëzimit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e organizimit të instruktimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimi ciklik i punës në frontet e shfrytëzimit.

Armatimi dhe shtrimi i shinave në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrit të punës gjatë punimeve të armatimit dhe shtrimit të shinave;
- Të shpjegojë Pasaportave teknike të armatimit dhe rëndësinë e zbatimit të saj;
- Të përshkruajë procesin e armatimit dhe metodat e realizimit të tij;
- Të listojë llojet e materialeve të armatimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së materialeve në procesin e armatimit të punimeve minerare;
- Të shpjegojë procesin e shtrimit të shinave;
- Të listojë materialet që përdoren në procesin e shtrimit të shinave;
- Të shpjegojë projektin e armatimit dhe shtrimit të shinave;
- Të shpjegojë rëndësia e zbatimit korrekt të Pasaportave teknike të shtrimit të shinave;
- Të shpjegojë funksionet dhe përdorimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës për armatimin e punimeve minerare;
- Të shpjegojë funksionet dhe përdorimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës për shtrimin e shinave;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të planit të armatimit dhe shtrimit të shinave;

Punimet ndihmëse dhe të mirëmbajtjes (armatimit, shtrimit të shinave, largimit të ujërave, sistemin elektrik) në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të shpjegojë elementët e planit të përgjithshëm të mirëmbajtjes së punimeve;
- Të shpjegojë elementët e plani të mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të punës;

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të shërbimeve të makinerive dhe pajisjeve;
- Të përshkruajë defektet e mundshme në makineri, pajisje dhe rëndësia e parandalimit të tyre dhe bashkëpunimit me ekspertët përkatës për eliminimin e tyre;
- Të shpjegojë metodat e mirëmbajtjes së armatimit;
- Të shpjegojë metodat e pastrimit/largimit të ujërave;
- Të listojë mjetet dhe materialet për largimin e ujërave;
- Të shpjegojë metodat e mirëmbajtjes së elementeve përbërës të shtrimit të shinave;
- Të listojë llojet e pompave për largimin e ujërave në minierë;
- Të shpjegojë metodat e mirëmbajtjes së sistemit elektrik dhe ndriçimit;
- Të listojë mjetet dhe materialet në sistemin elektrik dhe ndriçimit;
- Të shpjegojë metodat e mirëmbajtjes së sistemit të ajrimit në minierë;
- Të shpjegojë metodat e furnizimit dhe mirëmbajtjes me ajër të ngjeshur dhe ujë;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet për furnizimin me ajër të ngjeshur dhe ujë;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit dhe kontrollit të planit të përgjithshëm të mirëmbajtjes së punimeve.

Procesi i ngarkim-shkarkimit dhe transportit në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrin të punës në proceset e ngarkim-shkarkimit dhe transportit;
- Të listojë llojet dhe skemat e transportit;
- Të listojë mënyrat e ngarkim-shkarkimit;
- Të përshkruajë mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës për ngarkim-shkarkim, transport, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të makinerive dhe pajisjeve të ngarkim-shkarkimit dhe transportit në përputhje me urdhrin e punës
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e organizimit të instruktimit periodik;
- Të përshkruajë pikat e ngarkim-shkarkimit dhe mënyrat e funksionimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkërendimit të punës për eliminimin e defekteve/avarive të makinerive dhe pajisjeve të ngarkim-shkarkimit dhe transportit.

Sipërmarrje dhe edukim karriere.

- Të listojë llojet e dokumentacioneve dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së gjeologji-minierave;
- Të shpjegojë mënyrat e hartimit të planeve ditore, javore, mujore;
- Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të dokumentacionit;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së materialeve dhe grafikut të kohës së punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit të të dhënave për faturat;

- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së një oferte;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të çmimeve të tregut të materialeve, pajisjeve bazuar në standardet e gjeologji-minierave;
- Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së çmimit të një produkti;
- Të listojë llojet e faturave;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të faturave;
- Të shpjegojë rëndësinë e teknikave të marketingut;
- Të listojë llojet e proces-verbaleve duke shpjeguar mënyrat e hartimit të tyre.
- Të shpjegojë rëndësinë dhe metodat e zhvillimit profesional dhe të zhvillimit të karrierës;
- Të shpjegojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në profesionin “Përgjegjës në minierë”;
- Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të shpjegojë llojet e panairëve dhe ekspozitave;
- Të përshkruajë llojet e trajnimeve, kurseve teknike dhe literaturës bashkëkohore

Komunikimi dhe etika profesionale.

- Të shpjegojë parimet e punës në grup;
- Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të shpjegojë se çfarë është dhe çfarë përmban Kodi i etikës;
- Të listojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik;
- Të shpjegojë hierarkinë, bashkëpunëtorët dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e përdorimit të TIK në komunikimin me të tjerët;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale të minierës;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit.

- Të shpjegojë Standardin Ndërkombëtar 18001;
- Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin minerar shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të manualeve të makinerive, pajisjeve dhe veglave të punës;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të përshkruajë llojet e mjetet e ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë llojet e sinjalistikave në mjedisin e punës dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
- Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence/avarie;
- Të shpjegojë përdorimin e mjeteve të MZSH³;

³ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

- Të përshkruajë masat përkatëse gjatë përdorimit të lëndëve kimike;
- Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
- Të përshkruajë llojet e mbetjeve;
- Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të përshkruajë llojet e depozitimeve dhe rregulloret përkatëse për depozitim të mbetjeve;
- Të shpjegojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të shpjegojë llojet e tabelave të sigurisë teknike dhe rrethimit;
- Të shpjegojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të shpjegojë ndikimin e aktivitetit minerar në shëndetin e njeriut;
- Të shpjegojë llojet e veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë llojet e enëve nën presion dhe funksionimi i tyre;
- Të shpjegojë rregulloret e sigurimit teknik për punë me lëndë plasëse.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Gjeologji-Miniera” niveli IV, referuar nivelit IV të KEK, individi do të përforcojë shprehinë profesionale të fituar në Nivelin III, si dhe do të zotërojë shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Individi duhet të jetë i aftë:

Planifikimi dhe organizimi i punës.

- Të hartojë grafikun e daljes së punëtorëve;
- Të hartojë grafikun e punimeve të sektorit të tij;
- Të zbërthejë elementet e një urdhri pune;
- Të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me sektorë ose specialistë të tjerë;
- Të përdorë mjetet, makineritë dhe pajisjet sipas proceseve të punës;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të punës;
- Të menaxhojë burimet njerëzore;
- Të kontrollojë funksionalitetin e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të kryejë ndarjen e detyrave në ekip;
- Të sigurojë bazën materiale, mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës;
- Të sigurojë burimet e nevojshme (ujë, energji elektrike etj.);
- Të sistemojë vendin e punës;
- Të kontrollojë pastrimin e vendit të punës, mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të hartojë raporte për ecurinë e punës;

- Të hartojë dhe plotësojë evidenca të ndryshme;
- Të vlerësojë performancën e punonjësve;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe llojet e masave disiplinore për fushën përkatëse.

Punime në kërkim-zbulim në nëntokë dhe sipërfaqe

- Të përdorë dokumentacionin teknik gjeologo markshajderik në sektorin përkatës;
- Të përdorë metodikat e duhura në matjet gjeologo markshajderik (gjeomatik);
- Të konsultohet me shërbimin gjeologo-markshajderik (gjeomatik) të minierës për problemet e kërkim-zbulimit;
- Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e realizimit të punimeve të kërkim-zbulimit;
- Të përzgjedhë makineritë, mjetet dhe pajisjet sipas proceseve të punës;
- Të hartojë/zbatojë urdhrin e punës;
- Të udhëzojë vartësit e tij për zbatimin e urdhrin të punës;
- Të raportojë punën e kryer;
- Të ndjekë grafikun e miratuar të realizimit të punimeve të kërkim zbulimit;

Procesi i ajrimit në minierat nëntokësore.

- Të kontrollojë elementet përbërës të atmosferës së minierës;
- Të zbatojë/kontrollojë urdhrin e punës për ajrimin;
- Të kontrollojë pajisjet e ajrimit, funksionet dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të pajisjeve të ajrimit;
- Të kontrollojë punimet e ajrimit;
- Të përdorë metodat e matjes së përbërësve/elementëve të ajrimit dhe mjetet përkatëse;
- Të kontrollojë normat e lejuara të nivelit të gazeve dhe elementëve të tjerë të ajrimit në tabelat përkatëse;
- Të organizojë instruktimin të punonjësve për ajrimin;
- Të eliminojë avaritë në punimet e ajrimit;
- Të marrë masat e nevojshme në raste emergjence nëpërmjet kalimit në rrugëdaljet e dyta;
- Të informojë personat përgjegjës për ajrimin;
- Të bashkëpunojë me përgjegjës të ajrimit për kontrollin e skemës së ajrimit për sektorin e tij;

Punimet e hapjes dhe përgatitjes në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të kontrollojë zbatimin e urdhrin të punës për punimet e hapjes dhe përgatitjes;
- Të zbatojë pasaportat teknike të hapjes dhe përgatitjes;
- Të përdorë mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës për punimet e hapjes dhe përgatitjes;
- Të dallojë llojet e gabimeve të mundshme dhe masat parandaluese dhe korrigjuese të tyre;
- Të lexojë dhe interpretojë projektet e hapjes dhe përgatitjes;
- Të bashkëpunojë me shërbimin gjeologo-markshajderik (gjeomatik) për punimet e hapjes dhe përgatitjes;
- Të kontrollojë frontet e punës në hapje dhe përgatitje ;

Punimet e shfrytëzimit në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të mbikëqyrë zbatimin e urdhrat të punës gjatë punimeve të shfrytëzimit;
- Të zbatojë pasaportat teknike të shfrytëzimit;
- Të zbatojë pasaportat teknike të shfrytëzimit;
- Të dallojë llojet e punimeve të shfrytëzimit;
- Të përdorë mjetet, makineritë dhe pajisjet e punës për punime shfrytëzimi;
- Të eliminojë avaritë në procesin e shfrytëzimit;
- Të parandalojë avaritë në procesin e shfrytëzimit;
- Të informojë eprorët për ecurinë e punës;
- Të identifikojë llojet dhe frontet e sistemeve të shfrytëzimit;
- Të kontrollojë makineritë, mjetet, pajisjet e punës në punimet e shfrytëzimit;
- Të organizojë punën për instruktimin periodik të punonjësve;
- Të organizojë punën në mënyrë ciklike në frontet e shfrytëzimit;

Armatimi dhe shtrimi i shinave në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të mbikëqyrë zbatimin e urdhrat të punës gjatë punimeve të armatimit dhe shtrimit të shinave;
- Të zbatojë në mënyrë korrekte pasaportave teknike të armatimit;
- Të zbatojë metodat e realizimit të procesit të armatimit;
- Të dallojë llojet e materialeve të armatimit;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve në procesin e armatimit të punimeve minerare;
- Të ndjekë procesin e shtrimit të shinave;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve në procesin e shtrimit të shinave;
- Të zbatojë projektin e armatimit dhe shtrimit të shinave;
- Të zbatojë pasaportat teknike të shtrimit të shinave;
- Të kontrollojë përdorimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës për armatimin e punimeve minerare;
- Të kontrollojë përdorimin e mjeteve , makinerive dhe pajisjeve të punës për shtrimin e shinave;

Punimet ndihmëse dhe të mirëmbajtjes (armatimit, shtrimit të shinave, pastrimit të ujërave, sistemin elektrik) në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të respektojë planin e mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të ndjekë zbatimin e kalendarit të shërbimeve të makinerive dhe pajisjeve;
- Të kontrollojë mjetet dhe materialet për pastrimin e ujërave;
- Të zbatojë metodat e mirëmbajtjes së elementëve përbërës të rrugës së shinave;
- Të kontrollojë punën e pompave për largimin e ujërave në minierë;
- Të kontrollojë metodat e mirëmbajtjes së sistemit elektrik dhe ndriçimit;
- Të kontrollojë mjetet dhe materialet në sistemin elektrik dhe ndriçimit;
- Të kontrollojë metodat e mirëmbajtjes së sistemit të ajrimit në minierë;

- Të kontrollojë metodat e furnizimit dhe mirëmbajtjes me ajër të ngjeshur dhe ujë;
- Të kontrollojë mjetet dhe pajisjet për furnizimin me ajër të ngjeshur dhe ujë;
- Të zbatojë dhe kontrollojë planin e përgjithshëm të mirëmbajtjes së punimeve.

Procesi i ngarkim-shkarkimit dhe transportit në nëntokë dhe sipërfaqe.

- Të mbikëqyrë zbatimin e urdhrin të punës në proceset e ngarkim-shkarkimit dhe transportit;
- Të lexojë skemat e transportit;
- Të identifikojë llojet e transportit në minierë;
- Të monitorojë procesin e ngarkim-shkarkimit;
- Të mbikëqyrë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ngarkim-shkarkimit dhe transportit në përputhje me urdhrin e punës;
- Të organizojë instruktimin e punonjësve;
- Të kontrollojë pikat e ngarkim-shkarkimit dhe mënyrat e funksionimit të tyre;
- Të bashkërendojë punën për eliminimin e defekteve/avarive të makinerive dhe pajisjeve të ngarkim-shkarkimit dhe transportit.

Sipërmarrje dhe Edukim karriere.

- Të përdorë dokumentacionet e duhura gjatë veprimtarisë së vet;
- Të zbatojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së gjeologji-minierave;
- Të hartojë planet ditore, javore, mujore dhe dokumente të tjera të nevojshme;
- Të zbatojë format dhe mënyrat e arkivimit të dokumentacioneve;
- Të përditësojë dokumentacionin teknik;
- Të regjistrojë të dhënat për faturat;
- Të përpilojë një oferte;
- Të kontrollojë çmimet e tregut të materialeve, pajisjeve bazuar në standardet e gjeologji-minierave;
- Të llogaritë kosto të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
- Të plotësojë faturat;
- Të hartojë proces-verbale të ndryshme;
- Të zbatojë metodat e zhvillimit të karrierës;
- Të zbatojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në profesionin “Përgjegjës në minierë”;
- Të transmetojë në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe aplikimet e teknikave të reja në punë;
- Të marrë pjesë në panaire dhe ekspozita;
- Të marrë pjesë në trajnime dhe kurseve teknike;
- Të përdorë literaturën bashkëkohore.

Komunikimi dhe etika profesionale.

- Të zbatojë parimet e punës në grup;

- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të respektojë Kodin e etikës;
- Të përdorë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik;
- Të respektojë hierarkinë, bashkëpunëtorët në veprimtarinë profesionale;
- Të përdorë TIK në komunikimin me të tjerët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale të minierës;
- Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit.

- Të zbatojë Standardin ndërkombëtar 18001;
- Të përdorë standardet dhe legjislacionin minerar shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të mbikëqyrë zbatimin e përdorimit të manualeve të makinerive, pajisjeve dhe veglave të punës;
- Të kryejë saktë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;
- Të mbikëqyrë vartësit gjatë dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të përdorë mjetet e ndihmës së parë;
- Të kontrollojë sinjalistikat në mjedisin e punës dhe zbatimin e tyre;
- Të zbatojë procedurat e evakuimit për raste emergjence/avarie;
- Të kontrollojë përdorimin e mjeteve të MZSH⁴;
- Të marrë masat përkatëse gjatë përdorimit të lëndëve kimike;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
- Të kërkojë zbatimin e rregullave të sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të kontrollojë tabelat e sigurisë teknike dhe rrethimit;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të kontrollojë mbajtjen dhe përdorimin e saktë të veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive;
- Të kontrollojë enët nën presion dhe funksionimin e tyre;
- Të zbatojë rregulloret e sigurimit teknik për punë me lëndë plasëse.
- Të kërkojë dhe mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në miniera dhe karriera;
- Të kontrollojë dokumentin e instruktimit të punonjësve në minierë;
- Të afishojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të këshillojë punonjësit për aspekte të caktuara;

⁴ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

KOMPETENCA TË PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të ketë ide dhe nisma inovative, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jetë i matur dhe i sjellshëm me eprorët, vartësit, partnerët, etj.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kriteret e drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësisve të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partnerët, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese.
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtarinë shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij;
- Të reagojë në mënyra konstruktive ndaj kritikave;